



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Rruga “Abdi Toptani”, ish - hotel “Drini”, Tiranë

Tel; 04 2268141; Fax: 2268142

Nr. 107/3 Prot.

Tiranë, më 07.04.2017

**V E N D I M**

**Nr. 77, datë 07.04.2017**

***“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin nr. 28, datë 10.02.2017”***

Në mbështetje të kompetencës së parashikuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 e 15, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 77-118, të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Mbikëqyrjes dhe Inspektimit, në përfundim të procedurës së verifikimit,

**VËREJ SE :**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me Vendimin nr. 28 prot., datë 10.02.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 89 datë 25.07.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga Bashkia Dibër, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 26.04.2016, e në vazhdim”, mbi bazën e Programit të Verifikimit nr. 107/1 prot., datë 10.02.2017, ka vendosur kryerjen e procesit të kontrollit të akteve të emërimit, të cilat janë marrë në kundërshtim me kërkesat ligjore për respektimin e procedurave të rekrutimit në shërbimin civil, për periudhën nga data 26.04.2016 (momenti i përfundimit të mbikëqyrjes së realizuar më parë në këtë institucion) e në vazhdim.

Për realizimin e këtij procesi, fillimisht u njoftua institucioni, me shkresën nr. 107/2 prot., datë 10.02.2017, “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në Bashkinë Dibër nga grupi i inspektorëve, i autorizuar për këtë qëllim, të cilët u paraqitën në këtë institucion, në datën 06.03.2017 dhe administruan në cilësinë e provës aktet e mëposhtme;

- Struktura dhe organika e institucionit e miratuar me Vendimin nr. 132, datë 30.05.2016, të Kryetarit të Bashkisë Dibër.
- Listëpagesat e punonjësve të institucionit për periudhën maj 2016 - janar 2017.
- Aktet e emërimit në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe kontratat e punës në pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Në momentin e verifikimit, konstatohet se Bashkia Dibër, funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 132, datë 30.05.2016, të Kryetarit të Bashkisë, “Për miratimin e numrit të punonjësve të institucionit të Bashkisë Dibër për vitin 2016”.

Verifikimi është realizuar për periudhën që fillon nga momenti i mbikëqyrjes që është kryer më parë në këtë subjekt, deri në datën 06.03.2017.

Konstatohet se gjatë kësaj periudhe Kryetari i Bashkisë Dibër, në **28** raste ka emëruar punonjës nëpërmjet akteve të emërimit të përkohshëm, apo kontratave të përkohshme të punës në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke mos respektuar procedurat e rekrutimit.

Konkretisht, bëhet fjalë për emërimet e punonjësve, në pozicionet e mëposhtme:

1. \*\*\*\*\* me pozicion “*Specialist pranë Sektorit të Administrimit të Ujrave*”, në Drejtorinë e Bujqësisë, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, emëruar në detyrë, me aktin nr.171, datë 20.06.2016.
2. \*\*\*\*\* me pozicion “*Inspektor Veterinar*”, pranë Sektorit të Shëndetësisë, Higjenës, Veterinarisë, Prodhimit Bujqësor dhe Ushqimit, emëruar në detyrë me aktin nr.208, datë 27.06.2016.
3. \*\*\*\*\* me pozicion “*Specialist pranë Sektorit të Bujqësisë dhe Blegtorisë, në Drejtorinë e Bujqësisë*”, emëruar në detyrë me aktin nr.163, datë 20.06.2016.
4. \*\*\*\*\* me pozicion “*Specialist i Pyjeve, pranë Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave në Drejtorinë e Bujqësisë*”, emëruar në detyrë me aktin nr.162, datë 20.06.2016.
5. \*\*\*\*\* me pozicion “*Specialist pranë Sektorit të Bujqësisë dhe Blegtorisë në Drejtorinë e Bujqësisë*”, emëruar në detyrë me aktin nr.177, datë 22.06.2016.
6. \*\*\*\*\* me pozicion “*Specialist pranë Sektorit të Bujqësisë dhe Blegtorisë në Drejtorinë e Bujqësisë*”, emëruar në detyrë me aktin nr.365, datë 10.08.2016.
7. \*\*\*\*\* me pozicion “*Specialist pranë Sektorit të Bujqësisë dhe Blegtorisë në Drejtorinë e Bujqësisë*”, emëruar në detyrë me aktin nr.211, datë 27.06.2016.
8. \*\*\*\*\* me pozicion “*Specialist i Sporteve pranë Sektorit të Kulturës, Edukimit Komunikimit dhe Çështjeve Gjinore, në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike*”, emëruar në detyrë me aktin nr.230, datë 01.07.2016.
9. \*\*\*\*\* me pozicion “*Specialist i Turizmit, pranë Sektorit të Kulturës, Edukimit Komunikimit dhe Çështjeve Gjinore, në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike*”, emëruar në detyrë me aktin nr.166, datë 20.06.2016.

10. \*\*\*\*\* me pozicion “Përgjegjës i Sektorit të Financës”, emëruar në detyrë me aktin nr.197, datë 24.06.2016.
11. \*\*\*\*\* me pozicion “Specialist i Monitorimit, pranë Sektorit të Hartimit të Shërbimit dhe Monitorimit, Drejtoria e Planifikimit të Teritorit Urbanistikës dhe Pronave”, emëruar në detyrë me aktin nr.169, datë 20.06.2016.
12. \*\*\*\*\* me pozicion “Specialist i Hartimit të Politikave, pranë Sektorit të Hartimit të Shërbimit dhe Monitorimit, Drejtoria e Planifikimit të Teritorit Urbanistikës dhe Pronave”, emëruar në detyrë me aktin nr.273, datë 12.07.2016.
13. \*\*\*\*\* me pozicion “Përgjegjës i Sektorit të Hartimit të Shërbimit dhe Monitorimit, Drejtoria e Planifikimit të Teritorit Urbanistikës dhe Pronave”, emëruar në detyrë me aktin nr.207, datë 27.06.2016.
14. \*\*\*\*\* me pozicion “Specialist pranë Sektorit të Hartimit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, emëruar në detyrë me aktin nr.155, datë 16.06.2016.
15. \*\*\*\*\* me pozicion “Specialist personeli”, emëruar në detyrë me aktin nr.195, datë 22.06.2016.
16. \*\*\*\*\* me pozicion “Specialist, pranë Sektorit të Mbrojtjes Civile, Drejtoria e MNZHS dhe Mbrojtjes Civile”, emëruar në detyrë me aktin nr.181, datë 22.06.2016.
17. \*\*\*\*\* me pozicion “Specialist pranë Sektorit të Mbrojtjes Civile, Drejtoria e MNZHS dhe Mbrojtjes Civile”, emëruar në detyrë me aktin nr.165, datë 20.06.2016.
18. \*\*\*\*\* me pozicion “Specialist pranë Sektorit të Mbrojtjes Civile, Drejtoria e MNZHS dhe Mbrojtjes Civile”, emëruar në detyrë me aktin nr.245, datë 04.07.2016.
19. \*\*\*\*\* me pozicion “Specialist i Auditit pranë Sektorit të Auditit të Brendshëm”, emëruar në detyrë me aktin nr.247, datë 06.07.2016.
20. \*\*\*\*\* me pozicion “Përgjegjës i Sektorit të TIK, Drejtoria e Shërbimeve Juridike”, emëruar në detyrë me aktin nr.14, datë 23.01.2017.
21. \*\*\*\*\* me pozicion “Specialist pranë Sektorit të Mbrojtjes Civile, Drejtoria e MNZHS dhe Mbrojtjes Civile”, emëruar në detyrë me aktin nr.41, datë 01.03.2017.
22. \*\*\*\*\* me pozicion “Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë”, emëruar në detyrë me aktin nr.34, datë 14.02.2017.
23. \*\*\*\*\* me pozicion “Specialist i Planifikimit të të Ardhurave Lokale dhe Rakordimit të Tatim-Taksave, Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Zhvillimit Ekonomik dhe Financiar”, emëruar në detyrë me aktin nr.293, datë 13.07.2016.
24. \*\*\*\*\* me pozicion “Specialist i Buxhetit pranë Sektorit të Financës”, emëruar në detyrë me aktin nr.96, datë 26.04.2016.
25. \*\*\*\*\* me pozicion “Specialist për Çështje Gjinore, pranë Sektorit të Kulturës, Edukimit, Komunikimit dhe Çështjeve Gjinore, Drejtoria e Shërbimeve Juridike”, emëruar në detyrë me aktin nr.396, datë 17.08.2016.
26. \*\*\*\*\* me pozicion “Specialist në Sektorin e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve”, emëruar në detyrë me aktin nr.12, datë 21.01.2016.
27. \*\*\*\*\* me pozicion “Sekretar i Përgjithshëm”, emëruar në detyrë me aktin nr.43, datë 07.03.2016.
28. \*\*\*\*\* me pozicion “Përgjegjës, pranë Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, emëruar në detyrë me aktin nr.157, datë 20.06.2016.

Aktet që vërtetojnë situatën e paraqitur, janë të materializuara në procesverbalin e konstatimit, datë 06.03.2017, mbajtur nga grupi i inspektorëve dhe personat e kontaktit të përcaktuar nga ky

subjekt, në institucionin e Bashkisë Dibër, si dhe janë pjesë e provave të administruara gjatë hetimit administrativ të kryer për këtë rast.

Komisioneri vlerëson se duke vepruar në këtë mënyrë, titullari i institucionit, ka vepruar në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi, ç'ka në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës a), dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, i bën aktet absolutisht të pavlefshëm.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet apo keqinterpretime në implementimin e kësaj dispozite në praktikë.

Në vijim të këtij arsytimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo, si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Dibër, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart, dhe në bazë të pikës 1, të nenit 113, të po këtij ligji, të bëjë anulimin e akteve administrative të cituara më sipër.

Në këto kushte, bazuar në nenin 113, pika 2, e ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, anulimi i aktit ka pasoja edhe për të shkuarën, dhe për rregullimin e ligjshmërisë së këtyre rasteve, duhet që gjithë procedura për plotësimin e këtyre pozicioneve të punës, të fillojë nga e para, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

#### **Për këto arsye:**

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”; e nenin 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

**1.**Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Dibër, që për rregullimin e ligjshmërisë në lidhje me **28** (njëzetë e tetë) rastet e emërimit në kundërshtim me ligjin, të veprojë si më poshtë:

- ✓ Të anulojë aktin administrativ nr.171, datë 20.06.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*; në pozicionin “Specialist pranë Sektorit të Administrimit të Ujrave”.
- ✓ Të anulojë aktin administrativ nr.208, datë 27.06.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*; në pozicionin “Inspektor Veterinar”, pranë Sektorit të Shëndetësisë, Higjenës, Veterinarisë, Prodhimit Bujqësor dhe Ushqimit.

- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr.163, datë 20.06.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist, pranë Sektorit të Bujqësisë dhe Blegtorisë, në Drejtorinë e Bujqësisë*”.
- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr.162, datë 20.06.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist i Pyjeve, pranë Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave, në Drejtorinë e Bujqësisë*”.
- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr.177, datë 22.06.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist, pranë Sektorit të Bujqësisë dhe Blegtorisë, në Drejtorinë e Bujqësisë*”.
- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr. 365, datë 10.08.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist, pranë Sektorit të Bujqësisë dhe Blegtorisë, në Drejtorinë e Bujqësisë*”.
- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr.211, datë 27.06.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist, pranë Sektorit të Bujqësisë dhe Blegtorisë, në Drejtorinë e Bujqësisë*”.
- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr.230, datë 01.07.2016, për emërimin e punonjëses \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist, i Sporteve pranë Sektorit të Kulturës Edukimit Komunikimit dhe Çështjeve Gjimore, në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike*”.
- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr.166, datë 20.06.2016, për emërimin e punonjëses \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist, i Turizmit pranë Sektorit të Kulturës Edukimit Komunikimit dhe Çështjeve Gjimore, në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike*”.
- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr.197, datë 24.06.2016, për emërimin e punonjëses \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Financës*”.
- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr.169, datë 20.06.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist i Monitorimit pranë Sektorit të Hartimit të Shërbimit dhe Monitorimit, Drejtoria e Planifikimit të Teritorit Urbanistikës dhe Pronave*”.
- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr.273, datë 12.07.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist i Hartimit të Politikave pranë Sektorit të Hartimit të Shërbimit dhe Monitorimit, Drejtoria e Planifikimit të Teritorit Urbanistikës dhe Pronave*”.
- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr.207, datë 27.06.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Hartimit të Shërbimit dhe Monitorimit, Drejtoria e Planifikimit të Teritorit Urbanistikës dhe Pronave*”.
- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr.155, datë 16.06.2016, për emërimin e punonjëses \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist, pranë Sektorit të Hartimit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore*”.
- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr.195, datë 22.06.2016, për emërimin e punonjëses \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist personeli*”.
- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr.181, datë 22.06.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist, pranë Sektorit të Mbrojtjes Civile, Drejtoria e MNZHS dhe Mbrojtjes Civile*”.
- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr.165, datë 20.06.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist, pranë Sektorit të Mbrojtjes Civile, Drejtoria e MNZHS dhe Mbrojtjes Civile*”.

- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr.245, datë 04.07.2016, për emërimin e punonjësit **Refik \*\*\*\*\***, në pozicionin “*Specialist, pranë Sektorit të Mbrojtjes Civile, Drejtoria e MNZHS dhe Mbrojtjes Civile*”.
- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr.247, datë 06.07.2016, për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* në pozicionin “*Specialist i Auditit pranë Sektorit të Auditit të Brëndëshëm*”.
- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr.14, datë 23.01.2017, për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të TIK, Drejtoria e Shërbimeve Juridike*”.
- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr.41, datë 01.03.2017, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “*Specialist pranë Sektorit të Mbrojtjes Civile, Drejtoria e MNZHS dhe Mbrojtjes Civile*”.
- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr.34, datë 14.02.2017, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë*”.
- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr.293, datë 13.07.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “*Specialist i Planifikimit të të Ardhurave Lokale dhe Rakordimit të Tatim-Taksave, Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Zhvillimit Ekonomik dhe Financiar*”.
- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr.96, datë 26.04.2016, për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* në pozicionin “*Specialist i Buxhetit pranë Sektorit të Financës*”.
- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr.396, datë 17.08.2016, për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* në pozicionin “*Specialist për Çështje Gjinore pranë Sektorit të Kulturës, Edukimit, Komunikimit dhe Çështjeve Gjinore, Drejtoria e Shërbimeve Juridike*”.
- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr.12, datë 21.01.2016, për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* në pozicionin “*Specialist, në Sektorit e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve*”.
- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr.43, datë 07.03.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “*Sekretar i Përgjithshëm*”.
- ✓ Të anulohet aktin administrativ nr.157, datë 20.06.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “*Përgjegjës, pranë Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore*”.

2.Njësia përgjegjëse, të planifikojë veprimtarinë, me qëllim që anulimi i akteve të emërimit prej Kryetarit të Bashkisë, të kryhet në mënyrë të alternuar me procesin e shpalljes së pozicioneve të lira dhe fillimin e procedurës së konkurrimit, sipas neneve 22, 23, e vijues, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, duke e ndarë procesin e rregullimit të ligjshmërisë në dy faza.

3.Njësia përgjegjëse të hartojë për vitin 2017, planin e punës së pranimeve në shërbim civil, për zhvillimin e procedurave të konkurrimit, për pozicionet që do të mbeten të lira pas ekzekutimit të këtij vendimi, zbatimi i të cilit do të ndiqet nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke mbajtur parasysh orientimet, në pikat më sipër të këtij vendimi.

4. Njësia përgjegjëse, të fillojë procesin e rekrutimit për 28 pozicionet e lira në kuptim të ligjit, duke u kujdesur për përmbushjen e rregullave të përcaktuara në Kreun IV, “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për

*pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe duke u bazuar në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike.*

Në veçanti, njësia përgjegjëse në vijim të procesit, duhet të kujdeset për të respektuar kërkesat ligjore në procedurat si më poshtë:

- ✓ Të krijohen Komisionet përkatëse të pranimit dhe vlerësimit (*Komiteti i Përhershëm i Pranimit për nivelin ekzekutiv, Komiteti për Lëvizjen Paralele dhe Ngritjen në Detyrë*) sipas procedurës që do të ndjekë për të plotësuar pozicionet e punës, pjesë të shërbimit civil. Komisioni i vlerësimit ka për detyrë të kryejë vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në konkurrim, i cili konsiston në vlerësimin e jetëshkrimit, vlerësimin me shkrim (*përveç lëvizjes paralele*) dhe vlerësimin në intervistën e strukturuar me gojë.
- ✓ Të bëhen publike në faqen zyrtare, “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*”, në faqen zyrtare të Bashkisë Dibër dhe në stendat e njoftimeve për publikun, aktet si më poshtë:
  - a) Akti i shpalljes për plotësim, i pozicionit të lirë të punës në shërbimin civil. Të tregohet kujdes që ky akt të përmbajë të dhënat, e përcaktuara në pikën 8, të Kreut II, e pikën 5, Kreun III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si dhe të pikës 9, Kreu II, të pikës 4, Kreu VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si: përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës; pranim në shërbim civil; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimit (*arsimi i lartë përkatës*); dokumentacionin që do të paraqitet, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së kandidaturave; datën për paraqitjen e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrimin kombëtar; mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me aplikantët dhe elementë të tjerë ligjorë që duhet të përmbajë shpallja.
  - b) Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “*lëvizja paralele*” ashtu edhe për fazën e dytë “*pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë*”.
  - c) Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar përfundimisht (*lista përfundimtare*) për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “*lëvizja paralele*” ashtu edhe për fazën e dytë “*pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë*”.
  - d) Aktin e shpalljes së kandidatit të nxjerrë fitues me më shumë se 70% të pikëve nga Komisioni përkatës.

**5.** Njësia përgjegjëse e Bashkisë Dibër, të fillojë zbatimin e vendimit brenda **30 ditëve** nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me planin e masave organizative, që materializojnë veprimet administrative që do të kryhen, për zbatimin e këtij vendimi sipas fazave që do të realizohet.

6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

7. Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimeve, si dhe për çdo problem tjetër që ka të bëjë me administrimin e shërbimit civil, të komunikojë me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe të kërkojë asistencën e nevojshme, me qëllim realizimin e këtyre proceseve në përputhje me ligjin.

8. Të njoftohet për këtë vendim, Kryetari i Bashkisë Dibër dhe Njësia Përgjegjëse e këtij institucioni.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**